

VENDIM
Nr. 97, datë 12.5.2025

**MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s PËR SHQYRTIMIN
E KËRKESËS SË SHOQËRISË “GREEN ENERGY” SHPK PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET PRODHUES 2 mw**

Në mbështetje të neneve 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.5.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1172/17 prot., datë 7.5.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Green Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Për qëllime të shqyrtimit të këtij aplikimi janë ndjekur procedurat dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Paraqitja e kërkesës për licencim

- Shoqëria “Green Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1172 prot., datë 20.2.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Fillimi i procedurës së licencimit

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 53, datë 3.3.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- Në datat 4.3.2025 dhe 5.3.2025, ERE publikoi njoftimin për fillimin e procedurës në median e shkruar dhe në faqen zyrtare të internetit.

- Deri më datë 13.3.2025, datë kur përfundoi afati për paraqitjen e komenteve apo objeksioneve nga të tretët, nuk rezultoi të jetë paraqitur asnjë.

3. Vlerësimi i dokumentacionit dhe kërkesa për seancë dëgjimore

- Me shkresat nr. 1172/4 prot. dhe nr. 1172/5 prot., datë 6.3.2025, ERE njoftoi shoqërinë për vendimin nr. 53/2025 dhe zhvillimin e një seance dëgjimore në ambientet e ERE-s për sqarimin e dokumentacionit të munguar, si dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e procedurës dhe për zhvillimin e seancës dëgjimore, me qëllim marrjen e qëndrimit të saj lidhur me zbatimin e detyrimeve të shoqërisë në drejtim të afateve të ndërtimit/vënies në punë të centralit dhe/ose vlefshmërinë e kontratës.

- Në seancën dëgjimore të zhvilluar në ERE më datë 13.3.2025, mori pjesë vetëm përfaqësuesi i shoqërisë “Green Energy” sh.p.k., ndërsa nuk u paraqitën përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Gjatë seancës, shoqërisë iu sqarua dokumentacioni i munguar apo i plotësuar pjesërisht, i cili ishte njoftuar më herët edhe me shkresën nr. 1172/4 prot., datë 6.3.2025, dhe nga përfaqësuesi i shoqërisë u mor angazhimi për dorëzimin e tij. Në vijim, me qëllim përkujtesën e detyrimeve të lëna në seancë, shoqërisë iu dërgua një e-mail më datë 26.3.2025, i protokolluar në ERE me nr. 1172/6 prot. Shoqëria, me e-mailin e datës 7.4.2025, konfirmoi se ndodhet në fazën e mbledhjes së dokumentacionit të kërkuar dhe se do ta dorëzojë atë pranë ERE-s në ditët në vijim.

4. Zgjatja e vendimarrjes së bordit

- Në vijim të e-mailit të shoqërisë, datë 7.4.2025, me anë të të cilit është kërkuar kohë shtesë për depozitimin e informacionit/dokumentacionit të munguar të aplikimit, me vendimin nr. 65, datë 7.4.2025, Bordi i ERE-s vendosi të zgjasë me deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes.

- Në vijim të korrespondencës me shoqërinë, përmes shkresave të protokolluara nr. 1172/10 prot., datë 9.4.2025, nr. 1172/14 prot., datë 30.4.2025 dhe nr. 1172/16 prot., datë 2.5.2025, vlerësohet se mbetet ende për t'u sqaruar qëndrimi i MIE-s lidhur me zbatimin e detyrimeve të shoqërisë në drejtim të afateve të ndërtimit dhe/ose vënies në punë të centralit, si dhe vlefshmëria e kontratës. Po ashtu, mbetet për t'u dokumentuar mbështetja financiare nga banka, e shoqëruar me formatin respektiv të korrespondencës zyrtare me Bankën.

5. Shtyrja e afatit të vendimmarrjes

- Referuar nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i ERE-s vlerëson zgjatjen me 30 (tridhjetë) ditë të afatit të vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Green Energy” sh.p.k. për licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “Green Energy” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 2 mw.

2. Brenda 20 (njëzet) ditëve duhet të depozitohet në ERE qëndrimi i MIE-s lidhur me zbatimin e të afateve të ndërtimit dhe/ose vënies në punë të centralit nga shoqëria, si dhe mbështetja financiare sipas formatit respektiv të bankës.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Green Energy” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti